



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 datës 4 Qershor 2008, nenit 9 shkronja (h), 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Shkresën përcjellëse 02.1624-2/26 datë 28.04.2026 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit 15Nr.353/01-15238 dhe Shkresës sqaruese të dërguar përmes emailit zyrtar të datës 04.05.2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

#### **VENDIM**

#### **NDRYSHIMIN E TITULLARIT TË PALUAJTSHMERISË NGA SHKOLLA BUJQËSORE NË SHKOLLËN E MESME GJIMNAZI "ULPIANA" NË LIPJAN**

##### **Neni 1**

NDRYSHOHET emërtimi i titullarit të paluajtshmërive në njësitë kadastrale P-71409044-00846-12 në vendin e quajtur "Bezimeni" me sipërfaqe prej 8113m<sup>2</sup> dhe njësisë kadastrale P-71409044-00846-13 me sipërfaqe prej 6128m<sup>2</sup> e evidentuar në certifikatën e pronësisë Nr.55-2026 në ZK-Lipjan, nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan

##### **Neni 2**

Ndryshimi i titullarit ashtu siç u cek në nenin 1 të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të ristrukturimit të shkollave të qytetit të Lipjanit dhe bartjes së pronësisë të njësisë kadastrale me sipërfaqet e lartëcekura nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan, si pjesë e interesit publik.

### Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

### Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-463/06-29376  
Lipjan, më 30.06.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit  
Daut Azemi